

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA	
VRA E KRYEMINISTRIT - CED PREMIIJA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER	
SEKTORI I ARKIVËS - SECTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Dokumenti Nr. Document No. Org. Unit	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.
<u>01</u>	<u>1059/33</u>
No. of pages Nr. stranica No. pages	Date Datum Date
<u>PO</u>	<u>20/04/2018</u>
Prishtinë / a:	



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

---

*Ministria e Punëve të Jashtme - Ministarstvo Inostranih Poslova - Ministry of Foreign Affairs*

## RAPORT I PUNËS

*Për:*

Sh.T.Z. Ramush Haradinaj  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

*Nga:*

Znj. Rejhan Vuniqi  
Zëvendësministre në Ministrinë e Punëve të Jashtme

Prishtinë, 19 Prill 2018

## Hyrje

Pas emërimit tim në pozitën e zëvendësministres në Ministrinë e Punëve të Jashtme si dhe pas marrjes së detyrës nëmuajin shtator 2017, menjëherë kam ndërmarrë veprime konkrete në mbështetjen e punës të Ministrit të Punëve të Jashtme, sipas obligimeve ligjore të cilat i kam.

Pas profilizimit të punës nga ana e Ministrit të Punëve të Jashtme, unë kam filluar të merrem kryesisht me çështje diplomatike, si dhe diplomaci ekonomike por edhe detyra të tjera, brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme të cilat i kam pranuar nga ana e Zëvendëskryeministrit të Parë dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, SH.T.Z. Behjet Pacolli.

Në kuptim të kësaj, si dhe bazuar në fushëveprimin tim, të caktuar nga Zëvendëskryeministri i Parë dhe Ministri i Punëve të Jashtme, raportin e punës unë do ta ndaj në tri (3) pjesë dhe atë:

- I. Vizitat dhe aktivitetet brenda dhe jashtë Kosovës;
- II. Aktivitetet nga fusha e diplomacisë ekonomike;
- III. Aktivitetet e tjera në hartimin dokumenteve dhe grupeve punuese në Ministrinë e Punëve të Jashtme

### I. Vizitat dhe aktivitetet brenda dhe jashtë Kosovës

#### 11-Tetor 2017

Konferenca e Vishegradit dhe takimi me Ministrin e Jashtëm të Hungarisë Peter Szijarto;

#### 24 Tetor 2017

Vizita e zv. Ministrit të Shqipërisë në Kosovë, z. Etjen Xhafa dhe pregaditjet për mbledhjen e dy qeverive;

#### 28 Tetor 2017

Vizita zyrtare në Turqi, takime me Ministrin e Punëve te Jashtme të Turqisë, z. Mevlut Causoglu, me Kryeministrin e Turqisë z. Binali Yıldırım dhe Kryeparlamentarin z. İsmail Kahraman. U organizua edhe Forumi Ekonomik në mes te dy vendeve me fokus të veçantë në bashkëpunimin dhe shkëmbimin e ideve të të dyja vendeve;

#### 2 Nëntor 2017

Pjesëmarrja në tryezën e përbashkët të organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme me temën: "Luftimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmi që shpie në terrorizëm";

### **10 Nëntor 2017**

Pjesëmarrja në tryezën e organizuar nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor me temën: “Cilësia e ajrit në Kosovë, sfidat dhe veprimet”

### **13 Nëntor 2017**

Ministria e Punëve të Jashtme në bashkëpunim me KCSS organizon Konferencën Ndërkombëtare me temën: NATO dhe shtetet e Ballkanit perëndimor, rajoni përballë sfidave bashkëkohore të sigurisë”;

### **21 Nëntor 2017**

Pjesëmarrja në Sesionin e 33-të të COMCEC-ut e mbajtur në Stamboll të Turqisë në të cilën kanë marrë pjesë të gjitha shtetet anëtare të OBI-së, sesion ky i cili udhëhiqej nga Presidenti i Turqisë z. Recep Tayip Erdogan;

### **30 Nëntor 2017**

Vizita zyrtare në Washington DC dhe pjesëmarrja në Konferencën e organizuar nga Atlantic Council me temën: “Një stuh që po vjen, formësimi i së ardhmes së Ballkanit në një kohë të pasigurisë” ku ishin të ftuar të gjithë Ministrat e rajonit, eksperte të Ballkanit, diplomate dhe të tjera. Takime me zv. Sekretarin e shtetit Wes Mitchell dhe shumë Kongresmen amerikane;

### **7 Dhjetor 2017**

Pjesëmarrja në sesionin informues të Fondit të Ballkanit Perëndimor e organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Fondi i Ballkanit Perëndimor;

### **8 – 10 Dhjetor 2017**

Vizita dhe pjesëmarrja në Konferencën “Africa 2017” që u mbajt ne Egjipt, e cila ka mbledhur Presidentë të shteteve, krerët e Qeverive si dhe Ministra nga vende të ndryshme nga shtetet e Kontinentit afrikan. Takime me disa Ministra të Punëve të Jashtme të Somalisë, të Bregut të Fildishtë, takim me Drejtoren Ekzekutive të Bordit të Zhvillimit të Rwandes, Claire Akamanzi dhe zv. Ministra të Mozambikut. Temë diskutimi, njohja e Kosovës dhe zhvillimi i marrëdhënieve bilaterale dhe diplomatike mes shteteve tona;

### **17 Janar 2018**

Vizita në Strasbourg e bashku me Ministrin Pacolli dhe takimi me Ambasadoret e shteteve mike të Kosovës në Këshillin e Evropës si dhe me Sekretarin Gjeneral të Këshillit të Evropës z.Thorbjørn Jagland. Temë kryesore e diskutimeve, anëtarësimi në Këshillin e Evropës dhe Liberalizimi i vizave. Gjithashtu gjatë kësaj vizite Ministri Pacolli mbajti fjalim në sesionin e parë dhe të dytë të punës së KPSA-së.

### **23 Janar 2018**

Prita në takim një delegacion të Qeverisë së Suedisë, të udhëhequr nga zv. ministri për BE-së dhe Tregti në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Suedisë, z. Oscar Stenstrom. U fol përmundësitet e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve, mundësitet e investimeve në Kosovë, mundësitet e të bërit biznes etj;

### **29 Janar 2018**

Vizitë zyrtare në Suedi së bashku me Ministrin Pacolli. Takuam Ministren e Punëve të Jashtme të Suedisë znj. Margot Wllstrom, Sekretaren e shtetit në Ministrinë e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ndërkombëtar, Ulrika Modeer dhe përfaqësues nga Parlamenti Suedez. U diskutua përmundësitet e shtetit suedez ndaj Kosovës, përrugëtimin e integrimit evropian, procesin e liberalizimit të vizave dhe projektet që ndikojnë në përmirësimin e mirëqenjës së shtetasve tanë;

### **8 Shkurt 2018**

Ne kuadër të aktiviteteve për shënimin e 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, Akademja Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës organizoi një Konferencë ndërkombëtare me temën:” Festimi i 10 vjetorit të pavarësisë, arritjet dhe aspiratat”. Morën pjesë personalitete të shquara politike dhe akademike nga vendi dhe bota;

### **12-14 Shkurt 2018**

Së bashku me Ministrin Pacolli kemi marr pjesë në Konferencën Ministrore të Koalicionit Global përluftë kundër ISIS ndërkombëtare e cila u mbajt në Kuvajt me temën.;

### **17 Shkurt 2018**

Kemi qenë pjesë në Konferencën e Sigurisë në Munich

### **18 Shkurt 2018**

Me rastin e festimit të 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, Ministria e Punëve të Jashtme organizoi promovimin e dy librave nga Ministri Pacolli, njëra me titull ” Deklarata e Pavarësisë” dhe tjetra “ Kosovo Indenpendece in Compliance with International Law”.

### **22 Shkurt 2018**

Isha pjesë e Konferencës së organizuar nga Ambasada jonë në Bruksel dhe eurodeputeti İlhan Kyuchyuk ku morren pjesë shumë deputetë të PE, raportuesi për Kosovën Igor Soltes, përfaqësues të shoqërisë civile dhe media;

### **28 Shkurt 2018**

Prita në takim Drejtorin Ekzekutiv të Fondit të Ballkanit Perëndimor, z. Gjergj Murra, ku ndër të tjera diskutuam edhe për bashkëpunimin që ka Kosova me WBF, përkrahjen dhe mbështetjen që merr vendi ynë nga ky fond;

### **7 Mars 2018**

Isha pjesë e hapjes së javëve të Frankofonisë ku së bashku me Ambasadoret e shteteve frankofone në Kosovë, u bë prezantimi i programit të javëve të Frankofonisë që janë mbajtur për gjatë gjithë muajit Mars;

### **8 Mars 2018**

Me rastin e festës së 5 vjetorit të Akademisë Diplomatike të Kosovës dhe Ditës së Gruas, nëkuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme u organizua Konferenca ndërkombëtare me temën “ Diplomacia, Fuqizimi gjinor dhe ndërtimi i kombit”;

### **13 Mars 2018**

Së bashku me Ministrin Pacolli mirëpritem për vizitë zyrtare Ministrin e Punëve të Jashtme të Sllovenisë, z. Karl Erjavec si dhe në bashkëpunim me Oden ekonomike të Kosovës u organizua Forumi i përbashkët ekonomik mes dy shteteve;

#### **14 Mars 2018**

Së bashku me Ministrin Pacolli mirëpritem për vizitë zyrtare zv. Kryeministren dhe Ministren e Punëve të Jashtme të Kroacisë, zj. Maria Pejcinovic. Diskutuan shumë çështje me rendesi si në aspektin politik ashtu edhe në aspekte tjera të interesit të përbashkët;

#### **14 Mars 2018**

Gjithashtu prita në takim një delegacion të lartë nga Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës të kryesuar nga homologu im, zv. ministri për çështje evropiane dhe punë të jashtme të këtij shteti, z. Matthijs van der Plas. U diskutua agjenda evropiane, bashkëpunimi bilateral, mbështetja e Holandës në anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe përmbyllja e procesit të liberalizimit të vizave;

#### **15-16 Mars 2018**

Së bashku me Ministrin Pacolli morrem pjesë në takimin e përbashkët të Ministrave të jashtëm të Ballkanit Perëndimor me drejtues të lartë të Komisionit Evropian dhe Britanisë së madhe e cila u mbajt në Sarajevë

#### **20-21 Mars 2018**

Zhvilluan vizitë zyrtare në Belgjikë ku përveç takimit me Ministrin e Punëve të Jashtme të Belgjikës, z. Didier Reynders, takuan edhe shumë përfaqësues të Parlamentit Evropian, eurodeputeten Tanja Fayon, eurodeputetet, Hans van Balen dhe Ilhan Kyuchyuk si dhe një takim të veçantë me Komisionerin për Punë të Brendshme të BE-së, z.Dimitris Avramopoulos. Gjithashtu Ministri Pacolli raportoi para Komisionit për Punë të Jashtme pranë Parlamentit Evropian, AFET.

#### **22 Mars 2018**

Së bashku me Ministrin Pacolli në mjeshterë Ministrisë së Punëve të Jashtme mirëpritem eurodeputetin parlamentar, z.Ilhan Kyuchyuk;

#### **23-24 Mars 2018**

Morra pjesë në Samitin Ekonomik, Turqi – Kosovë e cila u mbajt në Bursa të Turqisë. Gjatë fjalimit tim ftova asalistet turq të investojnë në Kosovë si dhe falënderova shtetin turk për kontributin e tyre në stabilitetin, zhvillimin dhe promovimin e Kosovës në rrafshin ndërkombëtar si dhe në rrugëtimin e vendit tonë drejt integrimeve euro-atlantike;

#### **26 Mars 2018**

Kemi pritur në vizitë zyrtare Ministren e Punëve të Jashtme të Austrisë, Dr.Karin Kneissl. Vlerësuam nivelin e bashkëpunimit shumë të mirë dy-palesh në të gjitha fushat, duke shprehur zotimin për thellimin e këtij bashkëpunimi nëveçanti në nivelin ekonomik.

## **II. Aktivitete dhe puna në Diplomacinë Ekonomike**

- Nga analizat periodike të Ministrisë së Punëve të Jashtme për diplomacinë ekonomike deri më tani kemi identifikuar çështjet e ndryshme dhe jemi duke punuar për zgjidhjen e të gjithë këtyre çështjeve. Në rend të parë punohet për përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional. Lidhur me këtë vazhdimisht jemi në kontakt me ministritë e linjës, me KIESA-në, me OEK-un dhe me organizatat tjera. Të gjithë këto angazhimet i bëjmë me qëllim të mbrojtjes sa më të mirë të interesave ekonomike të vendit. Për të kaluar në një shkallë më të avancuar si dhe për të siguruar disiplinën organizativ lidhur me marrëdhëniet e jashtme ekonomike me stafin civil vazhdimisht ndajmë mendime, sidomos për hartimin e Strategjisë për diplomaci ekonomike. Lidhur me këtë është angazhuar Departamenti për diplomaci ekonomike dhe pritet që brenda disa ditëve të kompletohet përbërja e grupit punues për hartimin e strategjisë. Ndërkohë pas vendosjes së objektivës në Planin e Qeverisë Departamenti për Diplomaci Ekonomike ka mbledhur materiale dhe raporte të ndryshme që do të shërbejnë në draftimin e strategjisë në fjalë;
- Brenda afatit 100 ditorë kemi pasur aktivitete të ndryshme në fushën e diplomacisë ekonomike. Si nga Qendra, ashtu edhe nga përfaqësítë diplomatike të Republikës së Kosovës kemi pasur angazhime gjatë organizimit të forumeve ekonomike, pjesëmarrjes në panaire, pjesëmarrje në platforma të dypalëshe dhe shumë palëshe të karakterit ekonomik, angazhimi për zgjidhjen e kontesteve të ndryshme, si dhe bisedat dhe konsultimet me shtetet rrëth marrëveshjeve dhe iniciativave të ndryshme lidhur me fushën e ekonomisë;
- Në angazhimet dhe vizitat e Zëvendëskryeministrit të Parë dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, Sh.T.Z. Behgjet Pacolli si dhe në vizitat që kemi realizuar gjithmonë një prej temave kryesore ka qenë bashkëpunimi ekonomik. Në vizitat jashtë vendit vazhdimisht kemi pasur takimet edhe me institucionet ekonomike, organizatat dhe bizneset e ndryshme të vendeve të tjera. Gjithashtu Ministria e Punëve të Jashtme ka lehtësuar vizitat e ministrive të linjës. Para këtyre vizitave, sidomos të disa ministrave të linjës janë dërguar inputet dhe raportet lidhur me marrëdhëniet ekonomike të Republikës së Kosovës me shtetin i cili vizitohet. Vlen të theksojmë që të gjithë institucionet e larta para takimeve të rëndësishme me institucionet ekonomike të vendeve të tjera si dhe me organizatat ndërkombëtare ekonomike, duhet të kërkojnë përkrahje rrëth pikave të diskutimit për fushën e diplomacisë ekonomike. Në këtë formë do të sigurojmë përfaqësimin shumë më të mirë të institacioneve të Republikës së Kosovës në këto takime;

- Gjatë periudhës 100 ditore kemi organizuar Sesionin e Parë të Komisionit të përbashkët për bashkëpunim ekonomik me Slloveninë. Në të dy palët koordinimi është bërë nga ministritë e punëve të Jashtme, ndërsa në grupet punuese kanë marrë pjesë përfaqësuesit të institucioneve të dy shteteve. Vlen të theksojmë që në marginat e këtij aktiviteti është organizuar edhe Forumi Ekonomik Kosovë-Slloveni;
- Ministria e Punëve të Jashtme përveç pjesëmarrjes direkte në koordinimin e organizimin të forumeve brenda periudhës 100 ditore ka lehtesar komunikimin e KIESA-së, OEK-ut dhe disa organizatave tjera me akterë të Jashtëm. Ka angazhuar përfaqësitë diplomatike për organizimin sa më të mirë të aktivitetave. Prej tyre vlen të përmenden forumet dhe konferencat ekonomike në Romë-Itali, Torontë - Kanadë, Paris-Francë, Bursa-Turqi, etj.
- Ministria e Punëve të Jashtme së bashku me përfaqësitë e vendit dhe me koordinimin e KIESA-në si dhe me përfshirjen e ministrive dhe agjencive të linjës ka filluar me organizimin e sesioneve informative teknike përmundësítë ekonomike në Kosovë. Sesiuni i parë është realizuar më datë 7 prill në qytetin Malmo të Suedisë. Deri në fund të vitit do të organizohet edhe gjithsej 5 sesione në këto shtete: Gjermani, Austri, Zvicër, Francë dhe Turqi. Vlen të theksoj që po ashtu Ambasadat e RKS brenda këtyre 100 ditëve kanë organizuar mbledhje të ndryshme përmundësítë të investimeve në RKS;
- Ministria e Punëve të Jashtme ka pasur edhe disa takime me përfaqësuesit e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, me qëllim të vlerësimit të bashkëpunimit të komunave me komunat e shteteve tjera lidhur me mundësinë e zhvillimit të aktivitetave të ndryshme të qeverisjes lokale në fushën e ekonomisë. Deri në fund të këtij viti kemi planifikuar realizimin e vizitave në të gjithë komunat e RKS. Qëllimi i këtyre vizitave është identifikimi i potencialeve të pushtetit lokal si dhe promovimi i mundësive dhe potencialeve të tyre jashtë vendit;
- Gjithashtu me kërkesën e organizatave të ndryshme kemi nisur disa iniciativa. Si shembull, nga MMPH kemi kërkuar iniciimin e marrëveshjeve në rend të parë me katër vende (Itali, Bullgari, Slloveni dhe Gjermani) me qëllim të nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale që mund të zëvendësojnë Konventën e Bazilit në marrëdhëni tona dypalëshe, ashtu që kompanive të RKS-së të lehtësohet plasimi i metaleve të klasifikuar si dhe materialevë të tjera për riciklim në këto katër vende. Përmes kanaleve diplomatike kemi zhvilluar konsultimet paraprake me këto katër shtete;

- Gjithashtu në këtë periudhë kemi qenë insistues për zgjidhjen e disa pikave që ndërlidhet me marrëdhëniet ekonomike me vendet tjera. Si shembull, është shumë me rëndësi angazhimi i Ministrisë së Financave për zbatimin e Marrëveshjes për Themelimin e Programit Kornizë për Bashkëpunimin Financiar me Hungarinë. Sa më shpejt që është e mundur duhet të krijohet Komiteti drejtues dhe duhet të identifikohen projektet të cilat mund të financohen nga Marrëveshja në fjalë. Gjithashtu dëshiroj të theksoj edhe rëndësinë e angazhimit sa më të madhë të institucioneve të RKS në marrëdhëniet e tyre me vendet tjera që ndërlidhen me fushën e ekonomisë. Deri më tanë janë nënshkruar shumë marrëveshje të karakterit ekonomik që mund të shërbejnë në marrëdhëniet ekonomike të RKS me vendet tjera, si dhe zbatimi i tyre është për interes të Republikës së Kosovës. Duhet që ministritë në mënyrë periodike të bëjnë vlerësimë për zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruar në fushat që ndërlidhet me ekonominë;
- Përkundër disa vështirësive vërejmë iritjen e interesimit të akterëve të jashtëm për të zhvilluar marrëdhënie ekonomike me RKS. Ligji për Investime Strategjike ka ndikuar në iritjen e interesimit. Vlen të theksoj që misionet diplomatike të RKS-së kanë njoftuar organizatat e bizneseve të shteteve të tjera lidhur me mundësitë të reja që ofron Republika e Kosovës;
- Në fund ju shpreh që me hartimin dhe finalizimin e Strategjisë për Diplomaci Ekonomike si dhe me respektimin dhe zbatimin e objektivave të strategjisë, do të jemi më të fortë dhe më të quartë në marrëdhëniet ekonomike të vendit tonë me vendet tjera si dhe me organizatat ekonomike ndërkombëtare.

### **III. Aktivitetet dhe puna brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme**

- Pjesëmarrja në takime të rregullta me drejtor të departamenteve politike;
- Pjesëmarrja në grupin punues për hartimin e strategjisë për diplomaci ekonomike;
- Pjesëmarrja në grupin punues për hartimin e strategjisë për politikën e jashtme;
- Pjesëmarrja në grupin punues për hartimin e planit qeverisës të Ministrisë së Punëve të Jashtme;
- Pjesëmarrja në grupin punues për reformë dhe riorganizim të MPJ-së;
- Pjesëmarrja në grupin punues për hartimin e planit të punës;
- Pjesëmarrja në grupin punues për analizimin e gjendjes në shërbimin e jashtëm.